

INSPEKTORATI SHTETËROR I PUNËS DHE SHËRBIMEVE  
SHOQËRORE

**FUSHATA SENSIBILIZUESE DHE INSPEKTUESE  
NË SEKTORIN E NDËRTIMIT**

Ne kuadër të bashkëpunimit me ILO-n bazuar në Projektin “Platforma e Punësimit dhe Çështjeve Sociale” financuar nga Komisioni European me komponent, që synon forcimin e inpektoriave të punës së Ballkanit


## **INSPEKTORATI SHTETËROR I PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE**

gjatë periudhës **MAJ-QERSHOR 2018**, me trupën inspektuese ka kryer fushatë sensibilizuese e inspektuese në sektorin e ndërtimi.

## Rrjeti i inspektimit të punës në Shqipëri

**Është i shpërndarë në 12 Degë Rajonale ne te gjithe vendin. Struktura eshte prej 154 punonjesish ku 113 jane inspektor pune nga te cilet 27% jane femra.**

Nr	Degët Rajonale sipas Qarqeve	Kryeinspektor Rajonal	Inspektor/e Pune Total
1	Berat	1	4
2	Diber	1	4
3	Durres	1	8
4	Elbasan	1	8
5	Fier	1	7
6	Gjirokastër	1	4
7	Korçë	1	7
8	Kukës	1	3
9	Lezhë	1	4
10	Shkodër	1	7
11	Tiranë	1	32
12	Vlorë	1	7
	<b>Qender</b>		<b>15</b>
	<b>TOTALE</b>	<b>12</b>	<b>109</b>



## Objektivat e fushatës

Rritja e ndërgjegjësimit për rreziqet ekzituese në aktivitet ndërtuese.

Promovimi i praktikave të mira kundrejt rreziqeve specifike të rënies nga lartësitë dhe përdorimi i pajisjeve mbrojtëse personale në kompanitë e ndërtimit duke kontribuar në zvogëlimin e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale

Promovimi i bashkëpunimit ndërmjet inspektoriatëve të ndryshëm kombëtarë, shkëmbimin e informacionit, praktikave të mira, metodologjive të inspektimit dhe trajnimit, duke përfshirë mundësinë e organizimit të vizitave nga ekipet e përbashkëta të bashkëpunimit.



## Mbi zhvillimin e Fushates;

Trajnim I inspektoreve per menyren e kryerjes se kesaj fushate.

Hartimi I Planit me masa konkrete.

Eshtë, zhvilluar në rajonet:

TIRANË, DURRËS, ELBASAN, SHKODËR, VLORË, KORCË

ku u angazhua një staf prej 65 INSPEKTORE PUNE

Gjatë kësaj fushate u përdorën:

Postera , Fletëpalosje dhe Broshura për :

**Punën e padeklaruar,**

**Rreziqet** dhe praktikat e sigurta në ndërtim, në lidhje me rëniet nga lartësitë dhe përdorimin e MPM (Mjeteve Personale Mbrojtëse) etj.

Dokumentet qe u perdoren :

---

Dokumentacioni standart i inspektimit,

**Aneksi Nr 1** - Pyetsori specifik per aktivitetin ndertues.

**Aneksi Nr 2** – Me te dhena te pergjithshme te subjekteve

# Aktiviteti ndertim

---

Gjate Vitit 2018 jane realizuar gjithsej 1047 inspektime ne subjekte ndertuese, ose 8.7% e totalit te aktiviteve te inspektuara ne kete vit, nderkohe qe 45.8% e subjekte ndertuese jan inspektuar ne kuader te kesaj fushate.

Aktivitetet Ndërtuese zënë 8.5% të aktiviteve që klasifikohen në grupin « Prodhuesve të të mirave » ku bëjnë pjesë së bashku me Bujqësinë , Pyje , Peshkimin dhe Industrinë ,

*(sipas Burimi INSTAT, me gjendje në fund të vitit 2017)*

Gjate Fushates u realizuan gjithsej ;

**480 inspektime, verifikime dhe keshillime me 9272 vende pune (punemarres).**

## Aksidentet ne pune ne Sektorin e ndertimit

---

15% e aksidenteve te hetuara nga ISHPSHSH per vitin 2018 kane rezultuar ne sektorin e ndertimit.

Te dhenat flasin per 26 punemarres te aksidentuar, nga te cilet 5 kane humbur jeten.


Nderkohe, vetem gjate periudhes se fushates, u hetuan 2 raste aksidenti, ne rajonin Korçe, ku u aksidentuar 2 punemarres nga te cilet njeri me pasoje humbjen e jetes, per shkak te renies nga lartesia.

# Aktivite ndertimi

U realizuan gjithsej ;

**480 inspektime, verifikime dhe keshillime me 9272 vende pune (punemarres).**


Deget rajonale	Realizim Maj+Qershor
Tirane	256
Durres	39
Elbasan	53
Shkoder	34
Vlore	64
Korce	34




## Në këto aktivitete kanë rezultuar se:




7.5% e të punësuarve janë punëmarrëse femra.



27% e punëmarrësve të evidentuar paguhen e sigurohen me pagë minimale



12.7% e punëmarrësve të evidentuar punojnë mbi 48 orë pune në javë.



10.5% e punëmarrësve të evidentuar punojnë mbi 40 orë pune në javë.

# Tregues nga inspektimi


---

- Nuk eshte konstatuar organizim sindikal ne keto aktivitete.
- 14.6% e punëmarrësve të evidentuar jane konstatuar informal dhe qe punonin pa nje kontrate individuale pune. Kryesisht ne subjektet e vogla nenkontraktore.
- Ne 6.4% e subjekteve ndertuese eshte marre masa e pezullimit te punes per shkelje flagrante te dispozitave te legjislacionit te punes.
- 16.4% e subjekteve ndertuese jane paralajmeruar për shkelje te evidentuara.
- 1.6% e subjekteve jane sanksionuar

Gjatë kësaj fushate krahas dokumente standarte inspektuese, gjatë inspektimeve është plotësuar dhe dokumenti në formë pyetësi “Aneksi 1”,

Nga të dhënat e analizuar në raport me pyetësin në raport me situatën e reflektuar nga 19 pyetje të adresuara specifike rezultoi se ka qënë e nevojshme të ndërhyhet me masa në 1269 situata

**SUBJEKTE NDËRTIMI TË ANKETUARA, E KU KA QËNË E NEVOJSHME NDËRHYRJA, PËR MANGËSITË, SIPAS SHKALLËS SË RREZIKUT:**



# Kantiere ndërtimi me më shumë se një punëdhënës

Në 67.2% e subjekteve të inspektuara kishte më shumë se një punëdhënës në kantierin e ndërtimit.




Sipas shkalles se rrezikshmerise, nderhyrjet për shkak të mos koordinimit mes punëdhënësve në kantierin e ndërtimit janë vlerësuar për :

1.1% të subjekteve me shkallë rrezikshmërie shumë të lartë.

53.3% shkallë rrezikshmërie të mesme

45.6% shkallë rrezikshmërie të ulët.


**MOS KOORDINIM NDËRMJET PUNËDHËNËSVE NË VENDIN E NDËRTIMIT KA NEVOJË PËR NDËRHYRJE, PASI VENDI I PUNËS ËSHTË ME RREZIKSHMËRI TË NJË SHKALLE:**



### Informimi dhe trajnimi i punëmarrësve si element shume i rendesishem ne garantimin e nje pune te sigurt


Gjatë inspektimeve dhe ankimimeve të bëra në subjektet e ndërtimit kanë rezultuar se në 20.4% të totalit të subjekteve, punëmarrësit nuk janë të informuar dhe të trajnuar për rreziqet ndaj të cilave janë të ekspozuar dhe për masat parandaluese.

#### MBI INFORMIMIN DHE TRAJNIMIN E PUNËMARRËSVE, PËR RREZIQET NDAJ TË CILAVE JANË TË EKSPOZUAR DHE PËR MASAT PARANDALUESE



Nga totali i subjekteve të anketuara dhe të inspektuara në 29.8% të tyre ka qënë e nevojshme ndërhyrja dhe marrja e masave për informimin e punëmarrësve dhe trajnimit e tyre, për rreziqet ndaj të cilave janë të ekspozuar dhe për marrjen e masave parandaluese.

### INFORMIMI DHE TRAJNIMI I PUNËMARRËSVE, PËR RREZIQET NDAJ TË CILAVE JANË TË EKSPOZUAR DHE PËR MASAT PARANDALUESE




Sipas shkalles se rrezikshmerise se vendit te punes nderhyrjet mbi informimin e punemarresve jane:

Mos informimin dhe trajnimin e punëmarrësve, për rreziqet ndaj të cilave janë të ekspozuar dhe për masat parandaluese, ka nevojë për ndërhyrje, pasi vendi i punës është me rrezikshmëri të një shkalle:


**MOS INFORMIMIN DHE TRAJNIMIN E PUNËMARRËSVE, PËR RREZIQET NDAJ TË CILAVE JANË TË EKSPOZUAR DHE PËR MASAT PARANDALUESE, KA NEVOJË PËR NDËRHYRJE, PASI VENDI I PUNËS ËSHTË ME RREZIKSHMËRI TË NJË SHKALLE:**

- Në masën 41.2% shkallë rrezikshmërie e Ulët
- Në masën 44.9% shkallë rrezikshmërie e Mesme
- Në masën 13.2% shkallë rrezikshmërie e Lartë
- Në masën 0.7% shkallë rrezikshmërie Shumë e Lartë



## Përdorimi i pajisjeve mbrojtëse individuale

Anketimi tregon se në masën 30.7% të totalit të subjekteve ndertuese punëmarrësit përdorin pajisjet mbrojtëse individuale.



Pavarësisht numrit të madh të subjekteve që sigurojnë përdorimin e masave mbrojtëse individuale për punëmarrësit e tyre, ndërhyrja për përdorim dhe shtimin e tyre, sipas shkallës së riskut ka qënë e nevojshme:


Në masën 42.6% shkallë rrezikshmërie e Ulët

Në masën 39.1% shkallë rrezikshmërie e Mesme

Në masën 16% shkallë rrezikshmërie e Lartë

Në masën 2.4% shkallë rrezikshmërie Shumë e Lartë

**Mos përdorimi i pajisjeve mbrojtëse individuale nga punëmarrësit, ka nevojë për ndërhyrje, pasi vendi i punës është me rrezikshmëri të një shkalle:**



## Rreziku i rënies nga lartësia, gjatë punës për instalimin e skelave

Në subjektet e anketuara, për rreziku i rënies nga lartësia gjatë punës së instalit të skelave ka qënë present në 6.1% të tyre.

Sipas shkallës së riskut, ndërhyrjet për këtë kategori subjektsh kanë rezultuar:

Në masën 72% për shkallë rrezikshmërie e Ulët


Në masën 12% për shkallë rrezikshmërie e Mesme

Në masën 14% për shkallë rrezikshmërie e Lartë

Në masën 2% për shkallë rrezikshmërie Shumë e Lartë

### Rreziku i rënies nga lartësia, gjatë punës për instalimin e skelave

Subjekte ku nuk ekziston rreziku i rënies nga lartësia  
93,9%



Subjekte ku ekziston rreziku i rënies nga lartësia, gjatë punës për instalimin e skelave  
6,1%

- Subjekte ku ekziston rreziku i rënies nga lartësia, gjatë punës për instalimin e skelave
- Subjekte ku nuk ekziston rreziku i rënies nga lartësia

## Rreziku i rënies nga lartësia, për shkak të mungesës së rrethimit të sigurisë

Kane rezultuar se në 7.4% të subjekteve të ndërtimit ekzistonte rreziku i rënies nga lartësia për shkak të mungesës së rrethimit të sigurisë.

Ndërhyerjet për rrezikun e rënies nga lartësia për shkak të mungesës së rrethimit të sigurisë, kanë nevojë për ndërhyrje:


**Rreziku i rënies nga lartësia, për shkak të mungesës së rrethimit të sigurisë, ka nevojë për ndërhyrje, pasi vendi i punës është me rrezikshmëri të një shkalle:**

Në masën 58.5% për shkallë rrezikshmërie të Ulët

Në masën 12.3% për shkallë rrezikshmërie të Mesme

Në masën 26.2% për shkallë rrezikshmërie të Lartë


Në masën 3.1% për shkallë rrezikshmërie Shumë të Lartë



## Rreziku i rënies nga shkallët apo vinçi.

Nisur dhe nga proceset e punës të subjekteve të kontrolluara, rreziku i rënies nga vinçi apo shkallët ka rezultuar në 2.7% të aktiviteteve të kontrolluara.

**Rreziku i renies nga shkallet apo nga vinçi**



### **Dyshemetë e pasigurta e të rrezikshme**

Në 11.4% të totalit të subjekteve të kontrolluara ekzistonte mundësia e lëndimit për shkak të punës në dysheme të pasigurta.

Gjithsej për këtë rrezik është parë e arsyeshme ndërhyrja në 41 raste për riskt të ulët të lëndimeve që mund të shkaktoheshin nga një dysheme e pasigurt, në 39 raste, për rrisht të mesëm për dysheme të pasigurta dhe në 6 raste, me rrisht të lartë lëndimesh për dysheme të pasigurt.

### **Lëndimet për shkak të punës në lartësi.**

Në 39 raste të kontrolluara ka ekzistuar mundësia e lëndimit për shkak të punës në lartësi dhe të mos sigurimit të mirë të skelave apo vinçit për ngritjen e materialeve, e ku ndërhyrja ka qënë e nevojshme për shkak të rrishtit të ulët në masën 72% të ndërhyrjeve, në 16 % për rrisht të mesëm dhe 10% për rrisht të lartë.

### **Rreziku nga mos fiksimi i skelave sipas standartit.**

Në 44 raste të inspektuara mos fiksimi i skelave sipas standartit përbënte rrezik për lëvizshmërine e tyre.

### **Trajnimi specific i punëmarrësve që merren me montimin dhe ngritjen e skelave.**

Në 133 raste punëmarrësit që merren me montimin dhe ngritjen e skelave rezultojnë të kenë marrë trajnimin e duhur. Për pjesën tjetër janë marrë masat atje ku ky trajnim, ka patur nevojë nderhyrje urgjente dhe ndërhyrje për rrisht të lartë në 2.5% të rasteve të ndërhyrjeve.

### **Siguria e gropave apo hapsirave në dysheme.**

Në këto kontrole kanë rezultuar se në 89% të tyre, ishin marrë masat mbrojtëse për parandalimin e rreziqeve nga këto hapsira, ndërkohë për pjesën tjetër në 1.4% ndërhyrja për marrjen e këtyre masave ka qënë urgjente.

### **Siguria e rrugëkalimeve.**

Nga totali i masave të marra në 62% këto masa janë marrë në raste me rrezikshmëri të ulët për sigurinë e punëmarrësve.

### **Masat mbrojtëse kolektive**

Në 88% të inspektimeve të kryera në kantjere, ishin marrë masat mbrojtëse kolektive. Ndërkohë në 108 raste ose në 25% të inspektimeve ka qënë e nevojshme marrja e masave për ndërhyrje.

## Konkluzione pozitive:

---

- Permiresimi i situates qe disponojme ne si Institucion ne raport me kete sektor, duke permiresuar ndjeshem per ne vijim metodologjine e vleresimit te riskut per planifikim te ketyre subjekteve qe te kene monitorimin e vazhdueshem nga inspektoret e punes.
- Permiresimi I dokumentacionit qe perdor inspektori I punes dhe nje informacion me I shtuar per keto te fundit nga na profesionale.


**KUJIDES:** Nëse çatia është bërë me materiale të thyeshme, vendosni platforma për të ecur, kapakë mbrojtës për sipërfaqen e xhamit ose merrni masa të tjera për të parandaluar rënien e punëtorëve nga çatia.



Kur ndërtohen çati prej çeliku rreziku i rënies mund të zvogëlohet duke instaluar platforma të lëvizshme pune me ashensor.



Në të gjitha zonat e punës ku ekziston rreziku i rënies, duhet të ketë mbrojtje 360°. Kjo arrihet përmes rampave të dyfishta mbrojtëse, traversave që pengojnë rëshqitjen dhe sigurimit të një hapësire minimale midis platformave të punës dhe çfarëdolloj objekti. Rrjetat dhe ripar mbrojtës mund të risin sigurinë. Megjithatë, të gjitha këto nuk mund të parandalojnë rënien, por vetëm mund të zbusin pasojat e saj.



[www.inspektoriatiipunes.gov.al](http://www.inspektoriatiipunes.gov.al)  
Rr. Dervit Hima, Tiranë, Tel:042368466,  
[info@si.gov.al](mailto:info@si.gov.al)

## Puna në çati

Nëse punoni në çati pa masa mbrojtëse, mund të binë.

- Nga çatija
- Në hapësirat apo vrimat e çatëve
- Nëpërmjet materialeve të thyeshme mbuluese për çatitë dhe dritareve në çati

Të gjitha punimet në çati duhet të planifikohen paraprakisht, duhet të kontrollohen në mënyrën e duhur dhe duhet të kryhen vetëm nga punëtorë me njohuritë dhe kompetencat e nevojshme për atë punë. Të gjitha vendet e punës që kanë rrezikshmëri rënieje, duhet të sigurohen në mënyrën e duhur.




Nëse nuk është e mundur të vendosen parrakë mbrojtës dhe traversa, duhet të ekzistojnë masat alternative, si p.sh. një rjet sigurie ose pajisje sigurie të lidhura me ganoha sigurie.



Masat e kontrollit për të parandaluar rënien e punëtorëve mund të përfshijnë një rampë të sipërme mbrojtëse në një lartësi prej rreth 1 metër dhe një rampë të mesme mbrojtës në një lartësi prej rreth gjysmë metri mbi platformën e punës. Është gjithashtu e nevojshme të përdoret një traversë për të parandaluar rënien objekteve mbi njerëzit që punojnë nën të.

Kur aktivitetet kryhen mbi çati të nëshqitshme, zakonisht është e nevojshme të ketë mbrojtje përkatëse dhe të mjaftueshme në anët e çatisë.



Puna në lartësi mund të jetë e sigurt



Puna në çati

"Vende pune të sigurt dhe të shëndetshme"  
"Përdorni 1 masë efektive, është parandaluesi më i sigurt"

### Pajisjet personale mbrojtëse

Punëdhënësi duhet të sigurojë dhe mbajë pajisje mbrojtëse të përshtatshme, pa kosto për punëtorët, për t'i mbrojtur ata nga incidentet dhe rreziku i shëndetit. Punëtorët duhet të udhëzohen se si të përdorin siç duhet pajisjet personale mbrojtëse dhe të dinë se si të zbulojnë dhe raportojnë mangësitë.

Pajisja mbrojtëse personale duhet t'i përgjigjet përdoruesit; kushtojni vëmendje madhësisë, përzierjes dhe peshës. Punëtorët duhet t'i përdorin pajisjet siç duhet, ata që janë të përfshirë në përzgjedhjen e pajisjeve ka të ngjarë t'i përdorin ato.

Pajisjet duhet të mirëmbahen, të mbahen të pastra dhe në një vend të sigurt kur nuk janë në përdorim. Kur dëmtohen, duhet të zëvendësohen.

Informacioni mbi llojet e veçanta të pajisjeve mbrojtëse personale që do të përdoren varet nga rezultatet e vlerësimit të rrezikut.



Ato duhet të vihen gjithmonë kur një punëtorës ndodhet në vendin e ndërtimit dhe kur ndodhet në vendin ku punimet kryhen mbi kokë. Këto zona duhet të shënohen qartë me paralajmërime për sigurinë.

### Mbrojtje për fytyrën dhe sytë

Duhet të përdoren syze mbrojtëse, mbrojtës nga dielli ose masa të tjera të përshtatshme nëse punëtorët ka të ngjarë të ekspozohen ndaj rrezeve që mund të çojnë në dëmtime të syve ose të fytyrës.

Për shembull, në rast të ekspozimit ndaj grimcave fluturuese ose pluhurit, kimikateve, dritës apo ndonjë reza timi tjetër, dhe veçanërisht gjatë saldimit, saldimit me gaz, shpimit të gurit

### Mbrojtje për kokën



Kapelet e sigurisë duhet të përdoren për të mbrojtur kokën nga dëmtimet për shkak të objekteve që fluturojnë ose bien ose nga goditja me ndonjë strukturë.

### Mbrojtja e dëgjimit

Duhet të përdoren kufje ose tapa të përshtatshme për veshët kur punoni me makineri të zhurmshme ose gjatë gjithë kohës kur punoni në një pjesë të zhurmshme të vendit të ndërtimit.



KUJDES: Nëse duhet të bërtitni që dikush t'ju dëgjojë në një distancë prej 2 metrash, ka shumë të ngjarë të dëmtoni dëgjimin nëse nuk keni vendosur pajisje mbrojtëse, edhe nëse ekspozoheni për një kohë të shkurtër ndaj një situatë të tillë. Konsideroni mundësinë e zvogëlimit të zhurmës ose kohës së ekspozimit ndaj saj.

## Pajisjet e mbrojtjes personale ju ndihmojnë të qendroni të sigurt dhe të shëndetshëm



"Vende pune të sigurt dhe të shëndetshme"  
"Përdorni 1 masë efektive, edhe parandalues më i mirë"

### Mbrojtje për duart

Lloji i dorëzave varret nga rreziket e shikaktuara nga veprimtaria e punës për shembull, përdorni dorëza kundër mëshqitjes kur punoni me gurë, ose dorëza shumë rezistente për aktivitete të tjera të tilla si vendosja e shufrave të çelikut.

Duhet të përdorni gjithmonë mbrojtës për duart kur aktiviteti përshin:

- Kontakti me sipërfaqe të ashpra, të mprehta ose të dhëmbëzuara
- Kontakti ose shpërkatja me lëndë të rrehta, gjirryese ose toksike, të tilla si biumi dhe mëshira



### Mbrojtja e këmbëve

Këpuçit e sigurta përdoren kryesisht për t'u mbrojtur ndaj dy lloj meqeshe:

- Objektet e mprehta të tilla si gozhdët që çajné shollën.
- objektet që bien dhe mund të thyjnë gishtat e këmbëve

Kërkesa kryesore është që pjesa e sipërme e këpuçëve të përforcohet për të mbrojtur nga materialet që bien mbi këpuçë dhe të kenë një shtesë të mesme çeliku (për të mbrojtur kundër objekteve të mprehta të cilat mund të çajné shollën) dhe të ofrojnë një mbështetje të fortë.

Këpuçët e papërshkueshëm nga uji mund t'i plotësojnë këto kushte dhe ta mbrojnë personin që i vesh nga kontaktet me ujë, përfshirë këtu çimenton.



### Veshje kundër ujit

Veshjet kundër ujit dhe për kokën duhet të përdoren kur punohet në kushte moti të pafavorshme për t'i mbajtur punëtorët ngrohtë dhe thatë.



### Rroba me shkallë të lartë dukshmërie

Veshje reflektuese apo pajisje të tjera reflektuese duhet të përdoren kur ka ekspozim ndaj rrezikut të lëvizjeve të makinave.



### Mbrojtja e rrugëve të frymëmarrjes



Sa herë që jeni të ekspozuar ndaj substancave të dëmshme atmosferike, duhet të vishni pajisjet mbrojtëse për aparatit e frymëmarrjes. Lloji i pajisjes do të varret nga rreziku, punëtori dhe kushtet e punës.



### Parandalimi dhe ndalimi i rënies

Ripat e sigurisë, për të gjithë trupin, me modulim të pavarur duhet të përdoren në situata kur është e pamundur të përdoren mjete të tjera të përshtatshme për mbrojtjen nga rënia, si paj. mbrojtjen e kufjve ose si shtesë për sigurinë.

Sistemet për parandalimin e rënies i pengojnë punëtorët të jenë në pozita rënieje; për këtë duhet një rrip mes të bashku me litarët e sigurisë të kapur pas një garxhe të përshtatshme.

Sistemet e ndalimit të rënies nuk parandalojnë rënien, por reduktojnë distancën e rënies; ato përshijnë vendosjen e rripave, pajisje për thithjen e energjisë kinetike; një kablo sigurie të lidhur me garxhën përkatëse, mundësisht mbi punonjësin.



[www.inspektoriatipunes.gov.al](http://www.inspektoriatipunes.gov.al)  
Rr. Dervis Hima, Tiranë, Tel 042 368466,  
[infodeti.gov.al](mailto:infodeti.gov.al)


## Puna në skelë

Rënja nga lartësia mund të çojë në vdekje ose aftësi të kufizuar të përhershme.


Për të gjithë vendet e punës ku ekziston rreziku i rënies, si p.sh. hapësira në dysheme, skajet e ndërtesave, hapësirat për vendosjen e ashenorëve, çatë etj. është e nevojshme të zbatohen masat të përshatshme kontrolli për të parandaluar rënien e punëtorëve, ose kur kjo nuk është e mundur, duhet të zbatohen masa për të zbutur pasojat e rënies.

Parandalimi i rënies mund të arrihet duke vendosur litarë të dyfishtë mbrojtës, mbulesa dyshemeje, tripa sigurie që i pengojnë lëvizjen e punëtorëve në skajet e ndërtesave (ose litarë etj).

Zbutja e pasojave të rënies mund të arrihet duke përdorur rrjeta mbrojtëse, sisteme gjatëkëz për zbutjen e rënies, litarë mbrojtës dhe amortizues të energjisë që parandalojnë kontaktin e punëtorëve me objekte apo tokën (ndalues të rënies) etj.



Platformat dhe skelat duhet të instalohen dhe kontrollohen nga ekspertë para përdorimit të tyre të parë, si dhe gjatë përdorimit të vazhdueshëm.



Platforma e punës në skelë duhet të bëhet tërësisht me dërrasa. Platforma me gjerësi 600mm siguron qasje të sigurt dhe hapësirë të përshatshme pune.

Gjatë montimit dhe çmontimit të skelës, punëtorët duhet të marrin masa për të parandaluar rënien, të tilla si litarë mbrojtës ose të punojnë me pajtje që parandalojnë rënien.




## Parandaloni rëniet – Punoni me Masa Sigurie në Lartësi



Puna në skelë

**"Vende pune të sigurtsa dhe të shëndetshme"**  
**"Përdorni 1 masave efektive, është  
parandaluesi më i shtuar"**



Në çdo nivel të skelës duhet të ketë qasje të sigurt. Shkallët e përdorura për t'u ngjitur në skelë duhet të jenë të sigurta në të dyja anët, për të parandaluar rëshqitjen. Shkallët duhet të shtrihen të paktën 1 metër mbi nivelin e tokës për të siguruar mbajtjen e qëndrueshme.



Kur përdorni një skelë apo platformë të lëvizshme, duhet gjithmonë të siguroni (blokoni) rotat për të parandaluar lëvizjen e tyre aksidentale – dhe pamakët mbrojtës duhet të jenë në të njëjtin standard sikurse edhe skela.



KUJDES: Përveç inspektimit fillestar të sigurisë së skelës, kontrole të tilla duhet të bëhen gjithmonë kur bëhen modifikime, pas një periudhe mospërdorimi, ekspozimit ndaj motit të keq, efekteve sizmike, ose çdo gjëje që mund të ndikojë në qëndrueshmërinë ose stabilitetin e tyre, për të siguruar përdorimin e tyre.

Ekzaminimet mjekësore të punëtorëve duhet të jenë të detyrueshëm, në mënyrë që të përcaktojnë nëse punëtorët janë në gjendje të punojnë në lartësi.

[www.inspektoriatipunes.gov.al](http://www.inspektoriatipunes.gov.al)  
Rr. Dervis Hima, Tiranë, Tel:042368466,  
[info@sil.gov.al](mailto:info@sil.gov.al)

